

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
ADVENTURE GUIDE ALBANIA

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më datë 03.04.2024, une i nënshkruarit:

EMILIA AGNIESZKA GRABSKA, e datëlindjes 27.02.1990, lindur në Poloni, dhe banuese ne Tirane madhore dhe me zotesi të plotë për të vepruar, me numër personal identifikimi 90022716061

themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

ADVENTURE GUIDE ALBANIA

Shoqëria rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Neni 2: Selia

Njësia Administrative nr. 7, Bulevardi Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Tirane, Shqipëri.

Shoqëria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Aktivitet dhe konsulence ne fushen e turizmit.
- Aktivitetet e agjencive të udhëtimit. Guida turistike. Shërbimet e tjera të rezervimit dhe aktivitetet e lidhura me to. Aktivitetet e operatorëve turistikë.
- Hotelet dhe akomodimi i ngjashëm. Akomodime të tjera.
- Transport kombëtar dhe ndërkombëtar rrugor i pasagjerëve
- Aktivitetet e përkthimit dhe interpretimit.
- Aktivitetet e trajnimeve për zhvillimin profesional dhe personal.
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901, dt.14.04-08).

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 10.000 (dhjetemijë) Lekë, i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

1. **EMILIA AGNIESZKA GRABSKA**, është zotërues i 1 kuote, me 100 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë, në vlerën 10.000 lekë.

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **EMILIA AGNIESZKA GRABSKA**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

EMILIA AGNIESZKA GRABSKA

Emilia Grabaska
Grabaska